



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Në: KSC-BC-2020-07

Para: Gjykatësit të Vetëm
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 28 shtator 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publike

Vendimi për caktimin e datës për paraqitjen e parë të Nasim Haradinajt

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

**Mbrojtësit kujdestar për Nasim
Haradinajn**
Bastian Martens

GJYKATËSI I VETËM¹, në përputhje me nenet 39(6) dhe 41(5) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligjit") dhe rregullën 55(6) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 shtator 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar paraqiti kërkesë për lëshimin e fletarrestimit dhe urdhrit përkatës për transferim kundër Nasim Haradinajt ("z. Haradinaj").²
2. Më 24 shtator 2020, gjykatësi i vetëm lëshoi "Fletarrestim për Nasim Haradinajn",³ dhe "Urdhër për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara".⁴
3. Më 25 shtator 2020, z. Haradinaj u arrestua.⁵
4. Më 26 shtator 2020, z. Haradinaj u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.⁶

¹ KSCPR-2018, F00004, Kryetarja, *Vendim për caktimin e gjykatësit të vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, publik

² KSC-BC-2018-01, F00125, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë urgjente për fletarrestime dhe urdhra në lidhje me to*, 22 shtator 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2018-01, F00128/A03/COR/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i redaktuar publik i versionit të korrigjuar të fletarrestimit për Nasim Haradinajn*, 24 shtator 2020, publik.

⁴ KSC-BC-2018-01, F00128/A04/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i redaktuar publik i urdhrit për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik.

⁵ KSC-BC-2018-01, F00133, Administratorja, *Njoftim për arrestimin sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁶ KSC-BC-2018-01, F00137, Administratorja, *Njoftim për pranimin e Nasim Haradinajt në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 26 shtator 2020 ("Njoftimi i pranimit"), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

5. Më 26 shtator 2020, Administratorja caktoi Bastian Martensin si mbrojtës kujdestar për z. Haradinaj, në përputhje me pjesën 17(2) të Direktivës për Mbrojtësit dhe rregullën 21 të Rregullores për Ndihmë Juridike.⁷

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në përputhje me nenin 41(5) të Ligjit, një person i privuar nga liria nga Dhomat e Specializuara ose në emër të tyre, transferohet përmes metodës së udhëtimit të saktësuar në urdhrin e Dhomave të Specializuara dhe sillet pa vonesë para një gjykatësi të Dhomave të Specializuara.

7. Në përputhje me rregullën 55(6) të Rregullores, çdo person i arrestuar në bazë të fletarrestimit të lëshuar nga Dhomat e Specializuara nxirret pa vonesë të papërligjur para një paneli i cili duhet të bindet se personi në fjalë është informuar për arsyet e arrestimit dhe për të drejtat që gëzon në bazë të Ligjit dhe Rregullores.

8. Në përputhje me nenin 39(6) të Ligjit, seancat, duke përfshirë dhe paraqitjen e parë të të dyshuarit, janë publike, përveçse kur gjykatësi i Dhomave të Specializuara vendos ndryshe në përputhje Rregulloren.

III. DISKUTIM

9. Duke pasur parasysh se arrestimi i z. Haradinaj dhe transferimi i tij në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara u kryen përkatësisht më 25 dhe 26 shtator 2020, gjykatësi i vetëm e konsideron të përshtatshëm caktimin e seancës për paraqitjen e parë të z. Haradinaj para tij sa më shpejt që të jetë e realizueshme, duke mbajtur

⁷ Njoftimi i pranimit, para. 3.

parasysh kufizimet për shkak të COVID-19, me qëllim për të siguruar respektimin e të drejtave të z. Haradinaj sipas Ligjit dhe Rregullores.

10. Gjithashtu, duke theksuar se seanca mund të bëhet publike edhe jashtë sallës së gjyqit, gjykatësi i vetëm autorizon bërjen e fotografive në fillim të seancës.

IV. VENDIM

11. Për arsyet e përmendura më lart, gjykatësi i vetëm:

- a) **vendos** të thërrasë seancën për paraqitjen e parë të Nasim Haradinajt para gjykatësit të vetëm **të martën, 29 shtator 2020, në orën 15:00;** dhe
- b) **autorizon** Administratoren që të organizojë bërjen e fotografive në fillim të seancës për një minutë e gjysmë.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Vetëm

E hënë, 28 shtator 2020

Në Hagë, Holandë.